

SPECIFIKIME TEKNIKE

OBJEKTI: MIRMBAJTJE E ZAKONSHME SHKOLLA-KOPESHTE PER VITIN SHKOLLOR 2024

TE PERGJITHSHME

1. Te gjitha punimet qe do te kryhen duhet te jene ne perputhje me kushtet teknike te zbatimit ne fuqi.
Ne rast se gjate punes ne terren do te linde e nevojshme kryerja e punimeve te tjera te paparishikuara ne preventive te merret aprovimi i nenkontraktorit te punimeve.

PUNIME PRISHJE

- 1- Punimet e prishjeve do të përqëndrohen në heqjen e shtresave hidroizoluese të demtuara, prishjet e sivatimeve dhe pllakave të demtuara egzistuese, rivendosje e pajisjeve të demtuara sanitare (përfshirë aksesoret e montimit), heqjet e tubave të bllokuar apo demtuar egzistues të ujesjellsit dhe të kanalizimeve, pastrimi i plotë i mureve si dhe largimi i mbeturinave ndërtimore. Gjate prishjes do te kihet kujdes qe te mos shkaktohen demtime ne strukturen e mureve apo ate mbajtese te obejktit. Perpara fillimit te punes menyra e prishjes te aprovohet me pare nga mbikqyresi i punimeve.

PUNIME HIDROSANITARE

- 1- Keto punime do të përqëndrohen në ndërrimin e pajisjeve (wc, lavamane, mishelatore, rubineta, saracineska etj) sanitare të demtuara në tualete, në ndërrimin e linjave të vjetra (ne rast se do te dale e nevojshme gjate procesit te punes nga mbikqyresi i punimeve) të shkarkimit të ujrve të zeza deri të kusetat mbledhëse jashtë godinës si dhe ato të furnizimit me uje. Pajisjet e reja te jene te ngjashme me ato ekzisuese ndersa tubacionet do të jenë sipas dimensioneve egzistuese.
- 2- Ne rast te zevendesimit te sistemit të linjave furnizuese dhe shkarkuese do të bëhen provat me ngarkesë të plotë, dhe pas konfirmimit nga mbikqyrësi i ipunimeve duhet të vazhdojë me punimet e tjera të shtresave të hidroizolimit dhe të pllakave apo suvase.

PUNIME ELEKTRIKE

- 1- Punime elektrike nuk janë parashikuar pasi nuk është parë e nevojshme, por ne rast se gjate punes ne terren apo dhe nga verifikimi qe do te beje zbatuesi apo mbikqyresi del e nevojshme nderhyrja ne rrjetin e energjise elektrike te njoftohet kontraktori ne menyre qe te hartohet projekti i nderhyrjes se nevojshme dhe te vihete ne zbatim.
- 2- Ne rast te nderhyrjeve ne rrjetin elektrik ne objekte duhet te behet matja e tokezimit me aparatit perkates e rrjetit ne pergjithesi dhe per cdo pajisje dhe te behet dokumentimi me process-verbal ndermjet kontraktorit dhe mbikqyresit.

PUNIME SUVATIMI

- 1- Suvatimet do të kryhen në pjesët e mureve të cilat janë demtuar nga lagështira apo janë

kufjo. Pasi të jenë prishur suvatimet egzistuese dhe pastruar muret do të vazhdojë procesi suvatimit të ri.

Suvatim i brendshëm i mureve dhe tavaneve

Sprucim i mureve, me Llaç çimentoje të lëngët për përmirësimin e ngjitjes së suvasë dhe rforcimin e sipërfaqeve të muraturës, duke përfshirë skelat e shërbimit dhe çdo detyrim tjetër për të dhënë plotësisht fund sprucimit.

Suvatim i realizuar nga një shtresë me trashësi 2 cm Llaçi bastard m-25 me dozim për m²: rërë e lare m³ 0,005, Llaç gelqereje m-1:2 m³ 0.03, çimento 400 kg 6.6, uje, i aplikuar, me paravendosje të drejtuesve në mure, dhe e lëmuar me mistri e berdaf, duke përfshirë skelat e shërbimit si dhe çdo detyrim tjetër për të dhënë plotësisht fund suvatimit në mënyrë perfekte.

Në rast se do të vihen re dëmtime të strukturës të cilat vëne në dukje hekurin për llacin esuvase të mos përdoret gelqere por vetëm llac çimento dhe vetëm mbas aprovimit me shkrim të mbikqyresit të punimeve për mënyrën se si do të procedohet.

Tavan i suvatuar dhe i lyer me bojë

Te gjitha sipërfaqet që do të suvatohen do të lagen më parë me ujë. Aty ku është e nevojshme ujit do të shtohen materiale të tjera, në mënyrë që të garantohet realizimi i suvatimit më së miri. Në çdo rast kontraktori është përgjegjës i vetëm për realizimin përfundimtar të punimeve të suvatimit.

Materialet e përdorura:

Llaç bastard marka-25

Llaç bastard marka 1:2

Bojë hidroplastike.

Përshkrimi i punës:

Sprucim i tavaneve, me llaç çimentoje të lëngët për përmirësimin e ngjitjes së suvasë dhe rforcimin e sipërfaqes të muraturës duke përfshirë skelat e shërbimit dhe çdo detyrim tjetër për të bërë plotësisht sprucimin.

Suvatim i realizuar nga një shtresë me trashësi 2 cm llaç bastard marka -25 me dozim për m², rërë e larë 0,005m³, llaç bastard (marka 1:2) 0,03m³, çimento (marka 400), 6,6 kg, uje i aplikuar në bazë të udhëzimeve të përgatitura në mure e tavane dhe e lëmuar me mistri e berdaf, duke përfshirë skelat e shërbimit, si dhe çdo detyrim tjetër për të bërë plotësisht suvatimin me cilësi të mirë.

Lyerje dhe lëmuar i sipërfaqes së suvatuar të tavanit, bëhet mbas tharjes së llaçit, për tu lyer me vonë.

Lyerje e sipërfaqes me boje hidroplastike, minimumi me dy shtresa. Ngjyra duhet aprovuar nga Supervizori.

PUNIME BOJATISJE

1- Bojatisje bojra hidroplastike.

Proçesi i lyerjes me bojë hidroplastike i sipërfaqeve të mureve të brendshme kalon nëpër tre faza si më poshtë:

1-Përgatitja e sipërfaqes që do të lyhet.

Para lyerjes duhet të bëhet pastrimi i sipërfaqes, mbushja e gropave të vogla apo dëmtimeve të sipërfaqes së murit me ane të stukturimit me material sintetik dhe bërja gati për paralyerje. Në rastet e sipërfaqeve të patinuara bëhet një pastrim i kujdesshëm i sipërfaqes.

Para fillimit të procesit të lyerjes duhet të bëhet mbrojtja e sipërfaqeve që nuk do të lyhen. (dyer, dritare, etj) me anë të vendosjes së letrave mbrojtëse.

2- Paralyerja e sipërfaqes së brendshme të pastruar.

Në fillim të procesit të lyerjes bëhet paralyerja e sipërfaqeve të pastruara mirë me vinovil të holluar (Astar plastik). Për paralyerjen bëhet përzierja e 1 kg vinovil me 2.5-3 litra ujë. Me përzierjen e përgatitur bëhet paralyerja e sipërfaqes vetëm me një dorë.

Norma e përdorimit është 1 litër përzierje vinovil me ujë duhet të përdoret për 20 m² sipërfaqe.

3- Lyerja me bojë plastike e sipërfaqeve të brendshme.

Në fillim bëhet përgatitja e përzierjes së bojës plastike e cila është e paketuar në kuti.

Lëngu i bojës hollonhet me ujë në masën 20-30 %. Kësaj përzierje I hidhet pigmenti

derisa të merret ngjyra e dëshiruar dhe e aprovuar nga mbikqyresi i punimeve dhe pastaj bëhet lyerja e sipërfaqes. Lyerja bëhet me dy duar.

Norma e përdorimit është 1 litër bojë plastike e holluar duhet të përdoret për 4 -5 m² sipërfaqe.

Kjo normë varet ashpërsia e sipërfaqes së lyer.

PUNIME SHITESASH

1- Shtresa hidroizolimi

Hidroizolimi do të bëhet me emulsion bitumi dhe dy shtresa karton katrama. Siperfaqja duhet të jetë e pastër. Në sipërfaqet e sheshta, duhet më parë të jetë dhënë pendenca e duhur nëpermjet shtresave të parashikuara. Mbi shtresën e hidroizolimit me bikomponent do të vendosen shtresat e tjera të parashikuara sipas preventivit. Në rastin e tualeteve, duhet aplikuar hidroizolimi ne mure ne lartesine e tubacioneve.

2- Shtresa dhe veshje me pllaka

Riparimi i dyshemeve dhe veshjeve të mureve me pllaka

Riparimi për pllakat e dëmtuara ose për ato pllaka që mungojnë, të bëhet në këtë mënyrë:

Pllakat e dëmtuara duhen hequr me gjithë llaçin. Pastaj duhet, që vendi të pastrohet dhe të lahet me ujë me presion. Pllakat e reja të jenë me të njëjtën ngjyrë dhe me dimensione të njëjta si pllakat e vjetra dhe të vendosen në llaçin e shtruar. Llaçi për riparim duhet të përgatitet me përmbajtje: për 1,02 m² pllaka nevojiten 0,02 m³ llaç të tipit m- 15 me 4 kg çimento (marka 400). Pastaj, duhet që fugat të mbushen me masën përkatëse (bojak), të pastrohen dhe të kryhen të gjitha punët e tjera.

Pllakat do te vishen sipas riparimeve të pjesshme në vendet e sipërfaqeve të dëmtuara, ndersa shtrimi do te behet i plote ne tualete.

Per cdo paqartesi ne zerat e punimeve te preventivit dhe specifikimet teknike do te merret mendimi dhe aprovimi i inxhinierit përfaqësues të Autoritetit Kontraktor dhe mbikqyresit te punimeve.